



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Prishtinë, më 13 janar 2022

Z. Hajrullah Çeku, Ministër  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Sheshi “Nëna Terezë”, p.n.  
10000 Prishtinë, Kosovë

**Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me llogaritjen e përvojës profesionale të punës në rastin e konkursit për drejtor të Baletit Kombëtar të Kosovës**

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit lidhur me llogaritjen e përvojës profesionale të punës në rastin e konkursit për pozitën e drejtorit të Baletit Kombëtar të Kosovës si dhe rastet e tjera që lidhen me marrëdhënien e punës së balerinëve në Baletin Kombëtar të Kosovës.

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë nga z. Sinan Kajtazi, lidhur me çështjen e llogaritjes së përvojës profesionale të punës tek balerinët e Baletit Kombëtar të Kosovës, me theks të veçantë në rastin e konkursit për pozitën e drejtorit të Baletit Kombëtar të Kosovës, i shpallur më 26 tetor 2021, nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ankuesi njoftoi se llogaritja e përvojës profesionale të punës së balerinëve të Baletit Kombëtar të Kosovës nuk bëhet në bazë të datës së fillimit të marrëdhënies së tyre të punës, por llogaritja bëhet pas përfundimit universitar, kriter ky i cili nuk kërkohet për të themeluar marrëdhënie pune në cilësinë e balerinëve.

**Vlerësimi i Avokatit të Popullit**

Avokati i Popullit ka analizuar ankesën e z. Kajtazit dhe ka vërejtur se ajo ka të bëjë me çështjen e llogaritjes së përvojës profesionale të punës për balerinët që janë pjesë e Baletit Kombëtar të Kosovës.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit vëren se në Republikën e Kosovës nivel më i lartë i arsimimit në fushën e baletit është shkollimin i mesëm, përkatësisht shkolla e mesme e lartë profesionale, diploma e së cilës shërben si bazë për lidhjen e marrëdhënies së punës në cilësinë e balerinëve. Në këtë rast, Avokati i Popullit ka vërejtur se balerinët që kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë profesional pajisen me diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të lartë profesionale dhe mund të lidhin marrëdhënie pune dhe të ushtrojnë aktivitetin profesional në fushën e baletit. Ngjashëm është vepruar në rastin e balerinëve të Baletit Kombëtar të Kosovës, të cilët posedojnë diplomat e shkollimit të mesëm të lartë profesional.

Më tej Avokati i Popullit ka analizuar konkursin për drejtor të Baletit Kombëtar të Kosovës, i shpallur nga MKRS-ja më 26 tetor 2021, dhe ka vërejtur se kandidatët për drejtor të Baletit Kombëtar të Kosovës duhet të plotësojnë kriterin e shkollimit dhe të përvojës së punës, si në vijim:

“- *Drejtor i Baletit Kombëtar të Kosovës, zgjedhet personi me përgatitje profesionale universitare në fushën e artit dhe kulturës.*

- *Duhet të ketë (7) vite përvojë pune, duke përfshirë (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse.*

[. . .].”

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të bëhet ndaras nga njëra-tjetra.

Së pari, kriteri i vendosur për shkollimin universitar, edhe pse nuk është kriter i vendosur sipas Ligjit nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Avokati i Popullit e vlerëson si të arsyeshëm përderisa bëhet fjalë për një pozicion udhëheqës të një institucioni kombëtar, siç është rasti i pozitës së drejtorit të Baletit Kombëtar të Kosovës.

Së dyti, Avokati i Popullit konsideron se kriteri rreth përvojës profesionale të punës duhet të vlerësohet ndaras nga kriteri i shkollimit universitar, për shkak se këto kriterë nuk janë të lidhura njëra me tjetrën. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se shkollimi universitar nuk është kriter për të lidhur marrëdhënie pune në Baletin Kombëtar të Kosovës, por shkollimi i mesëm profesional, prandaj edhe llogaritja e përvojës profesionale të punës duhet të bëhet duke llogaritur periudhën prej lidhjes së marrëdhënies së punës. Në situata të tilla, të dyja kriteret e theksuara më sipër (shkollimi universitar dhe përvoja e punës) duhet të plotësohen ndaras njëra nga tjetra.

Në këtë rast, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se në Republikën e Kosovës niveli më i lartë i arsimimit në fushën e baletit është shkollimi i mesëm, përkatësisht shkolla e mesme e lartë profesionale, konsideron se balerinët e plotësojnë kushtin për të lidhur marrëdhënie pune, me përfundimin e shkollimit të mesëm profesional dhe me pajisjen me diplomë të shkollimit të mesëm të lartë profesional. Në këtë drejtim përvoja profesionale e punës për balerinët duhet të llogaritet periudha nga momenti i lidhjes së marrëdhënies së punës me Baletin Kombëtar të Kosovës.

Prandaj në konkursin e theksuar më sipër kriteri i shkollimit universitar duhet të dëshmohet me paraqitjen e diplomës universitare, ndërsa kriteri i përvojës së punës duhet të dëshmohet me dokumentin përkatës të përvojës së punës, duke mos u llogaritur vetëm ajo periudhë pas përfundimit të shkollimit universitar, por përvoja prej momentit fillestar të lidhjes së marrëdhënies së punës.

Për situata të ngjashme të llogaritjes së përvojës profesionale të punës para diplomimit, Avokati i Popullit ka publikuar Opinion nr. 207/2018, i datës 31 janar 2018, fryma e të cilit mund të merret parasysh edhe në rastin e pozicionit të balerinëve të Baletit Kombëtar të Kosovës.

### **Përfundim**

Avokati i Popullit vlerëson se kriteret e konkursit për pozitën e drejtorit të Baletit Kombëtar të Kosovës duhet të përmbushen ndaras njëra nga tjetra.



Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se përvoja profesionale e punës për balerinët duhet të llogaritet periudha prej momentit kur ata kanë lidhur marrëdhënie pune me Baletin Kombëtar të Kosovës, pa marrë parasysh a kanë pasur shkollim universitar, por vetëm ta kenë të përfunduar shkollimin e mesëm të lartë profesional në fushën e baletit. Kjo do të ndikojë në realizimin e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës për balerinët e Baletit Kombëtar të Kosovës.

Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se ky interpretim duhet të realizohet në çfarëdo situatë që lidhet me të drejtat e balerinëve që rrjedhin nga marrëdhënia e tyre e punës me Baletin Kombëtar të Kosovës, duke i përfshirë përvojën e punës për pensionim si dhe rastet e tjera për të cilat është e nevojshme llogaritja e përvojës së punës së balerinëve.

 Me nderime,  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

Bashkëngjitur: Opinion nr. 207/2018 i Avokatit të Popullit, i datës 31 janar 2018, lidhur me çështjen e interpretimit të konceptit “përvojë e punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike.